

VENDIM
Nr.66, datë 9.2.2006

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2006, MIRATUAR PËR
MINISTRINË E BRENDSHME, PËR DHËNIE NDIHME FINANCIARE FAMILJES SË
ZOTIT NIKOLL NDUE GJIKOLA, POLIC I PLAGOSUR NË KRYE TË DETYRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 8 të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Brendshme, në buxhetin e miratuar për vitin 2006, t’i shtohet fondi prej 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekësh, për dhënie ndihme financiare familjes së z. Nikoll Ndue Gjikota, polic në komisaratin e policisë, Mirditë, i plagosur në krye të detyrës.
 2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.
 3. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha